

TIME AND SPACE IN GEORGE ORWELL NOVELS KOHË DHE HAPËSIRA NË ROMANET E GEORG ORWELL-IT

Emine SHABANI¹

^{1*} Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova

*Corresponding author e-mail: emine.shabani@unite.edu.mk

Abstract

Georg Orwell's novel *Animal Farm* places the focus of events on Mr. Jones's farm in Northern England. Although in terms of time frame, the novel, like 1984, is current for all time. At the *Animal Farm*, allusions flow to the October Revolution of 1917, in which the Bolsheviks rose up against the Tsarist Russia of Nicholas II. Space itself, the animal farm where the author places the events, sheds sarcastic light on the events he narrates. The focus of events is injustice, wrongful interventions, manipulation of the popular masses, the establishment of the communist order, which is nothing but the hidden desire for one dictator to be replaced by another.

The author prudently directs the satire and parody, from the historical events of this time, which are documented, explaining the object of the novel in a genius way. At first glance, the theme is light and simple and looks like a children's book, but a little scratching under the surface of the novel is enough to reveal and expose the terrible and hegemonic history of the Soviet Union, which keeps them under the animal rule, oppressed peoples.

Keywords: *dystopian fiction, utopia, existentialism, resistance and collapse of utopia, colonial discourse.*

Përmbledhje

Romani Ferma e kafshëve e Georg Orwell-it vendos fokusin e ngjarjeve në fermën e z. Jones në Anglinë Veriore. Për sa i përket kornizës kohore, romani, ashtu si edhe viti 1984, është aktual për të gjitha kohërat. Në Fermën e Kafshëve, aludimet kanë të bëjnë me Revolucionin e Tetorit të vitit 1917, në të cilin Bolshevikët u ngritën kundër Rusisë Cariste të Nikollajt II. Vetë hapësira, ferma e kafshëve ku autori e vendos narracionin, hedh dritë sarkastike mbi ngjarjet që rrëfen. Fokusi i ngjarjeve është padrejtësia, ndërhyrjet e gabuara, manipulimi i masave popullore, vendosja e rendit komunist, që nuk është gjë tjetër veç dëshira e fshehur që një diktator të zëvendësohet nga një tjetër.

Autori drejton me maturi satirën dhe parodinë, nga ngjarjet historike të kësaj kohe, të cilat janë të dokumentuara, duke shpjeguar objektin e romanit në mënyrë gjeniale. Në shikim të parë, tema është e lehtë dhe e thjeshtë dhe duket si një libër për fëmijë, por mjafton një gërvishtje e vogël në sipërfaqe për të zbuluar dhe ekspozuar historinë e tmerrshme dhe hegjemoniste të Bashkimit Sovjetik, i cili i mban popujt e shtypur, nën sundimin e "kafshëve".

Fjalët kyçe: *trillim distopik, utopi, ekzistencializëm, rezistencë dhe shembje e utopisë, diskurs kolonial.*

Hyrje

Autori me maturi e drejton satirën dhe parodinë, nga ngjarjet historike të kohës së Revolucionit të Tetorit të vitit 2018 dhe kohës mes dy Luftërave Botërore, aleancat mes fuqive europiane dhe rrezikun e shtrirjes së ideologjisë komuniste në Evropë, duke sqaruar objektin e romanit në mënyrë gjeniale. Në vështrim të parë, tema është e lehtë dhe e thjeshtë dhe duket sikur libër për fëmijë, por mjafton pak të gërvishtim në sipërfaqe, për të zbuluar dhe ekspozuar historinë

e tmerrshme dhe hegjemoniste të Bashkimit Sovjetik, e cila i mban nën qeverisje animale popujt e shtypur.

Vend të rëndësishëm në këtë histori zë lideri dhe ideologu i Revolucionit të Tetorit, Lenini. Trashëgimtari i tij, Stalini tregohet akoma më i ashpër dhe më grabitqar, se pararendësi i tij. Stalini manipulon me masat, duke krijuar iluzionin e lirisë, por në fund zgjedhja e tij është hegjemonia. Autori përdor satirën, ironinë dhe parodinë, nëpërmjet personazheve kafshë, të cilat personifikojnë personalitetet udhëheqëse të shtetit të parë komunist në botë.

Qëllimi i këtij studimi është të analizojë krijimin e mitit për njeriun e ri. Kjo prirje e distancon letërsinë nga njeriu si individ, nga subjekti, i cili bëhet subjekt i një ikonografie sunduese dhe i një kodifikimi të përgjithshëm të karakterit njerëzor.

Metoda, e dekonstruksionit, analitike, psikanalitike etj.

Rezultatet dhe diskutimi: Studimi *Koha dhe hapësira në romanet e Georg Orwellit* merret me çështjen komplekse të titullit dhe synon t'i përgjigjet pyetjes se si autori G. Orwell e sheh të ardhmen përmes optikave filozofike, artistike, psikologjike, sociologjike dhe kritike, e kaluara dhe e tashmja. Kështu, vizioni i së ardhmes, si tema kryesore e këtij studimi në korpusin distopik të këtij punimi, kuptohet si një kontekst i fuqishëm për kritikën e kushteve ekzistuese shoqërore dhe sistemeve politike dhe paralajmërimin e pasojave negative të mendimit utopik.

Qëllimi i këtij studimi është të analizojë krijimin e mitit për njeriun e ri. Kjo prirje e distancon letërsinë nga njeriu si individ, nga subjekti, i cili bëhet subjekt i një ikonografie sunduese dhe i një kodifikimi të përgjithshëm të karakterit njerëzor. Njeriu i ri socialist është një nga projektet më kontradiktore në historinë politike të njerëzimit, qëllimi i të cilit është të modulojë, adaptojë, kontrollojë, kodifikojë dhe programojë temën dhe përparimin shoqëror në funksion të interesave të paracaktuara. Miti i njeriut të ri është pjesë e një modeli të njohur paradigmatic: ideologjia komuniste, rendi komunist, familja komuniste, etj. Korpusi i përfshirë në këtë punim përfshin romanet e mëposhtëm: 1984, Ferma e Kafshëve.

Termi "mbinjerëzor" me ndryshime, shpesh përdoret në terma kritikë rreth distopisë për t'iu referuar tejkalimit të përvojës njerëzore. Paradoksi mund të shpjegohet me shembullin e kuptimit të dyfishtë të fjalëve "pasuri" dhe "varfëri". Në 1984, për shembull, Orwell e krahasoi pasurinë ekonomike me varfërinë shpirtërore. Pikërisht sepse shpirtërorja është pothuajse joekzistente, varfëria materiale përcaktohet në roman si pasuri e vërtetë, sepse sjell me vete një përvojë të plotë njerëzore. Në këtë kontekst, vdekja nuk është një humbje, por një shpëtim nga një jetë e mjerueshme dhe e frikshme. Jungu në emisionin e radio Berlinit, i intervistuar nga gazetari Nikerboker, në vitin 1939, e deshifron strukturën mendore, të Stalinit me këto shprehje:

Stalini është thjesht një përndjekës, një fshatar dinak, i egër, një interpretues i pavetëdijshëm - dhe në atë kuptim, ai është padyshim më i fuqishëm se të gjithë diktatorët. Ai na kujton atë tigër të majmë siberian me dhëmbë si shpata, me ato mustaqe të sheshta, me atë buzëqeshje si maçoku i ajkës. Unë mendoj se edhe Stalini mund të jetë Xhingiskan. Nuk do të habitesha nëse ai do të bëhej mbret.

(Jung 2006:166)

Nga kapitulli i shtatë deri tek i nënti, derrat më shumë ngjajnë me njerëzit, se sa me kafshët. Në ekspozicion, romani hapet me revoltën e kafshëve, të nxitur nga indiferenca e pronarit pijanec, z. Jones, i cili harron t'i ushqejë ata. Kafshët e marrin qeverisjen mbi fermën. Narratori me zhdërvjelltësi i paraqet personazhet e kafshëve, duke e përshtatur secilin personazh në mënyrë të veçantë, por edhe një grup personazhesh me karakteristika të ngjashme. Ai i përshkruan karakteret e kafshëve të veçanta, duke shfrytëzuar mjeshtërisht personifikimin, metonimin dhe metaforën. Në fillim kafshët fillojnë të sillen si njerëzit.

Ata flenë në krevate, pinë alkool, vishen me rroba, etj. Pela Moli, mban kapelë të kuqe dhe ha sheqerka, sikurse njerëzit. Kafshët krijojnë infrastrukturë në bashkësinë e tyre. Ideja e Snowball-it është të ndërtojnë mulli ere. Napoleoni në anën tjetër është dembel në ndërtimin e fabrikave dhe institucioneve, ai gradualisht vendos hegjemoninë e fermës. Napoleoni, fshehurazi, fillon të vrasë kafshë dhe tregton me ta, duke u vendosur rregulla të cilat ai vetë nuk i respekton. Me fjalë tjera, ata fillojnë të ngjajnë më shumë me njerëzit se me kafshët dhe, kulmi i transformimit do të arrihet kur Napoleoni fillon të ecë me dy këmbë. Kjo përfaqëson demagogjinë e tij perfide, si udhëheqës i revoltës së kafshëve, e më pas ligjvënës i cili një herë i vendos rregullat dhe më vonë i ndryshon me dinakëri.

Në fillim kafshët nuk janë njerëz, por ata gradualisht dhe dinakërisht i ndryshojnë gjendjen e tyre të parë dhe, fillojnë t'i imitojnë njerëzit. Pas kulminacionit, njëlloj sikurse në jetën reale, edhe në veprën letrare, zgjidhja vjen kur z. Jons zëvendësohet nga Napoleoni dhe Snowball-i. Romani përfaqëson parodizimin dhe satirizimin e historisë së vërtetë të Rusisë së viteve njëzetë e tridhjetë të shek XX. Hapat që pasojnë pas këtij ndryshimi drastik të derrave, janë dhënë sipas parimit të Petrarkës "Festina lente", ose "shpejto ngadalë". Ata ndryshojnë përmes strategjisë së manipulimit të masave, struktura mendore dhe psikologjike e Stalinit ndryshon në të njëjtën kohë.

Jungu e shtjellon përvojën e Stalinit me Partinë Komuniste dhe përshtatjen e papritur të Carit pas njëzet e pesë vitesh luftë kundër tij. Ai e shpjegon:

Nuk ka asgjë të çuditshme këtu. Sepse do të bëheni ai me të cilin luftoni vazhdimisht. Kush e pushtoi forcën luftarake të Romës? Krishterimi. Pas pushtimit të Lindjes së Mesme, Romakët u pushtuan nga feja ... Ju duhet t'i njihni dhëmbët e carizmit për ta mposhtur atë. Kur ta hiqni mbretin, do të bëheni mbret. Si përshtatet një gjuetar i kafshëve të egra në natyrë? Unë njoh një njeri i cili, pas shumë vitesh gjuetie të madhe ... u arrestua për përdorimin e një pushke kundër kafshëve. Ai u bë gjakatar, si panterat dhe luanët që vrau. Kjo vlen edhe për luftën e Stalinit kundër shtypjes së përgjakshme perandorake. Tani ai sillet ashtu si mbreti i tij. Sipas mendimit tim, Stalini nuk ndryshon nga Ivani i tmerrshëm.

(Jung 2006:181)

Edhe këtu duhet të kemi parasysh aspektin funksional të historisë, sepse Napoleoni paraqitet si një figurë e zezë. Aspekti simbolik i kësaj figure është i rëndësishëm, ai është i zi si djalli, jo i bardhë si derrat tjerë në fermë. Zëri i kafshëve të fermës është një lloj hije kolektive. Boksieri dhe Beniamini janë dy miq të pandashëm. I pari është një kalë i fuqishëm dhe punëtor. I dyti është një gomar që, duke përfaqësuar elitën intelektuale ruse, i kupton më mirë intrigat e Napoleonit, ndryshe nga kafshët tjera që nuk janë në gjendje t'i kuptojnë ato.

Por Benjamin nuk ka fuqi t'i rezistojë ndikimit dhe fuqisë së Napoleonit dhe derrave tjerë. Këto forca dhe ndikime vijnë nga armiqtë e jashtëm dhe të brendshëm. Hapësira për kundërveprim dhe reagim është shumë e vogël, minimale, madje edhe lëvizja më e vogël është një shenjë e revoltës së pafytyrë që Napoleoni nuk e toleron. Kështu ai menjëherë i lëshon qentë posaçërisht të stërvitur. Sipas Jungut, lufta e brendshme me vetëdijen tonë është më e rënda, ndaj së cilës asnjëherë nuk do të mundemi të korrim fitore të plotë.

Beniamini shoqërohet vetëm me Boksierin, i cili personifikon fuqinë punëtore - njerëzit. Rregullat, të shkruara nga Snowball-i, menjëherë pas marrjes në zotërim të fermës së Jones-it, do të ndryshohen në mënyrë perfide nga komplotet e Napoleonit. Ky sundimtar hegjemon është i interesuar më shumë në artin e dominimit, sesa në ndërtimin dhe infrastrukturën e fermës. Snoubolli, i cili sipas shumë kritikëve përfaqëson Leo Trocky-in, është i interesuar të përmirësojë infrastrukturën e ndërtimit dhe mirëqenien e të gjithëve. Sidoqoftë, ai do të kundërshtohet nga Napoleoni, i cili do ta pengojë atë në një mënyrë perfide.

Ai më vonë do ta shpallë tradhtarin në një takim të fermës, me këtë rast duke justifikuar rregullin e pestë, sipas së cilit asnjë kafshë nuk ka të drejtë të vrasë një kafshë tjetër përveç se kur tradhëton. Me kalimin e kohës, Napoleoni do të ndryshojë rregullin numër shtatë, sipas të cilit asnjë kafshë nuk duhet të flejë në një shtrat me çarçafë të bardhë. Ai do ta bëjë këtë sepse, si një torturues me instinkte dhe impulse më të fuqishme, nuk mund t'ua rezistojë gjërave të mira, që lë Jones-i pas largimit nga shtëpia dhe ferma.

Në mënyrë tinëzare, Napoleoni dhe të burgosurit e tij besnikë do ta thyejnë rregullin që vendosën vet, duke fjetur në shtretërit e shtëpisë së Jones-it. Ata jo vetëm që shkelin rregullat e tyre, por marrin produktet e punës së tjerëve. I pari që i hetoi këto çështje është Benjamini, i cili ia thotë në besim Boksierit. Derrat marrin vezët nga pulat, qumështin nga lopët, dhe gjithashtu hanë frutat dhe perimet të mbjella nga kafshët e varfra, që vuajnë nga uria dhe puna e rëndë. Përveç kësaj, pëllumbat përhapën fjalën në fermat tjera që të gjithë duhet të ndjekin rregullat e fermës së tyre, e cila është një parajsë për kafshët.

Lajmi i përhapur nga pëllumbat aludon në propagandën komuniste të Bashkimit Sovjetik që synon përhapjen e komunizmit në sa më shumë vende që të jetë e mundur. BRSS shpesh dërgonte misionarët e saj politikë për të formuar parti komuniste kryesisht në vendet e Evropës Lindore, por kishte një tendencë që komunizmi të përhapej në perëndim, si në Spanjë, Itali, Francë, Gjermani dhe vende të tjera. Sidoqoftë, komunizmi nuk kishte gjasa të përhapej drejt perëndimit. Në kohë të caktuara dhe në rrethana të ndryshme historike, pëllumbat do të përpiqen të bindin punëtorët e pafat të fabrikave dhe fshatarët e varfër të revoltohen, por gjithçka përfundon me dështim.

Spanja ka tendencën më të madhe për të përhapur komunizmin. Shumë intelektualë nga e gjithë bota po marrin pjesë në Luftën Civile Spanjolle, duke luftuar në anën e Republikanëve. Shumë njerëz vdesin në një luftë që lë gjurmët e saj të përgjakshme në të gjithë vendin. Sidoqoftë, Lufta Civile Spanjolle, me gjithë kaq humbje njerëzish dhe shkatërrim të tmerrshëm të vendit, është dështim i komunizmit.

Romani Ferma e kafshëve tregon mjeshtërinë krijuese të Orwell-it, i cili që në fillim e paraqiti një sistem të pasuksesshëm, në një mënyrë frymëzuese. Kjo vepër gjithashtu përcjell vizionin dhe profecinë e qartë të autorit për dështimin e sistemeve komuniste, kolonialiste dhe neokolonialiste. Këto rregullime krijojnë iluzionin e lirisë midis popujve që janë në të vërtetë, nën kontrollin e sistemeve distopike, qëllimi i vetëm i së cilave është të vazhdojnë sundimin e tyre për aq kohë sa të jetë e mundur. Dostojevski thotë:

Në vend të një ligji të lashtë, të qartë dhe të ngurtë, Ti [O Zot] e bërë njeriun të vendosë për të mirën dhe të keqen e tij, pa i dhënë udhëzime të tjera me shembullin Tënd. Sidoqoftë, a nuk do ta neglizhojë një person shembullin tënd, madje as do ta vejë në dyshim atë, si dhe të vërtetën tënde, kur ai mbart barrën e tmerrshme të lirisë së zgjedhjes?

(Dostojevski, 1984:72).

Para së gjithash, mos gënjeni veten. Njeriu që gënjen dhe dëgjon gënjeshtrenë e tij, përballet me momentin kur nuk mund ta njohë të vërtetën tek ai ose rreth tij dhe, për këtë arsye humbet çdo respekt për veten dhe të tjerët. Pa respekt, ai pushon së dashuruari.

(Dostojevski, 1984:476).

Në Fermën e Kafshëve, ashtu si në 1984 dhe romane tjera, Orwell u drejtohet lexuesve me gjuhë figurative, metaforike, simbolike, metonimike, alegorike dhe satirike në mënyrë që të rrisë ndërgjegjësimin për rreziqet e iluzionit të lirisë. Autori dërgon gjithashtu një paralajmërim për rrezikun e shfrytëzimit të punës njerëzore, e cila mund të bëhet objekt i shtypjes ose kontrollit nga varfërimi. Nga ana tjetër, varfëria do ta parandalonte njeriun nga arsimimi, krijimin e një vizioni për të ardhmen e tij dhe arritjen e qëllimit të tij jetësor. Orwell-i e përshkruan këtë fenomen në 1984 në librin e Goldenstein:

Kapitulli 1. Injoranca është fuqi. Gjatë kohës historike dhe ndoshta nga fundi i kohës neolitike, kishte tre shtresa njerëzish në botë: të gjatë, të mesëm dhe të ulët. Ato ndahen në shumë mënyra, duke mbajtur shumë emra të ndryshëm dhe numri i tyre relativ, si dhe lidhja e tyre me njëri-tjetrin, kanë ndryshuar nga moshë në moshë: por struktura themelore e shoqërisë nuk ka ndryshuar kurrë. Edhe pas trazirave të mëdha dhe ndryshimeve në dukje të pakthyeshme, i njëjti model përsëritet gjithmonë, ashtu si xhiroskopi gjithmonë që kthehet në ekuilibër, pa marrë parasysh sa larg shtyhet, në një mënyrë apo në një tjetër. Qëllimet e këtyre grupeve janë plotësisht të papajtueshme.

(Orwell 2009:1098)

Ajo që është e qartë në çdo nivel semantik të veprave të Orwell-it, janë emocionet dhe idetë filozofike që përcillen si vizione të qarta të lexuesi, duke e pasuruar atë me njohuri të reja. Lexuesi duhet t'i njohë saktësisht veprimet e tyre të njëkohshme groteske. Në veprat e Orwell-it, ne shohim njoftimin e pastër të njohurive krijuese. Mund të thuhet se është ndoshta i vetmi në llojin e tij që ka mbetur i paprekur nga mizoritë dhe monstruoze të qenësishme të na rrethon. Në Fermën e Kafshëve, shpirti njerëzor nënkupton gjendjen e tij trupore.

Gjendja shpirtërore që përshkruan Orwell-i mishëron lloje të ndryshme të kafshëve sipas kushteve të jetesës, lakmisë, instinkteve dhe egoizmit të udhëheqësve të kombeve, duke përfshirë edhe të metat e popujve të tyre. Askush nuk është i kursyer nga pena e mprehtë e kritikës së Orwell-it, veçanërisht ata që nuk reagojnë ndaj katastrofës që po godet popullin e tyre. E gjithë drama e kafshëve, e cila zhvillohet në fermë, përfaqëson anën tokësore, trupore dhe materiale të njeriut-tjetërsimit të tij. Orwell-i në Fermën e Kafshëve na tregon pjesën shtazarake të natyrës njerëzore. Nuk ka asgjë ideale dhe njerëzore në botën e kafshëve. Humanizmi është zhdukur, njerëzit janë dehumanizuar. Nga këto, mbeti vetëm ana primitive, shtazore.

Karakteri i Majorit të Vjetër është i rëndësishëm në roman, sepse si nismëtar i rebelimit të kafshëve, ai përfaqëson ideologjinë dhe lëvizjen. Ky personazh ndërthur dhe mishëron dy ideologjët komunistë: Marx-in dhe Leninin. Puna është e dominuar nga logjika e arsyes trupore dhe pasioneve, si dhe instikti për pushtet dhe autoritet. Majori i vjetër i nxit kafshët të këshillohen për veprime të mëtejshme, pasi gjendja është e favorshme për rebelim. Në rrethana kur Jones torturon kafshët dhe nganjëherë harron t'i ushqejë ato, Majori i Vjetër përfiton nga rasti për t'i mësuar kafshët se ato nuk duhet të lejojnë që të shfrytëzohen.

Narratori e përdor këtë moment të rëndësishëm, për satirën e tij të fuqishme të drejtuar kundër ideologjisë komuniste. Nëse historiani tregon atë që ka ndodhur, shkrimtari duhet të tregojë se çfarë mund të ketë ndodhur. Orwell portretizon një vizion të tillë të supozuar në romanin e tij. Ferma e kafshëve është roman alegorik i zhanrit të fiksjonit distopik. Romani ndjek gjithashtu procesin me të cilin njerëzit-kafshët fitojnë pjekuri politike. Diktatori ende ka nevojë të përdorë fjalën "kafshë" për t'i ulur njerëzit në nivelin e kafshëve dhe t'i bëjë ata subjekt të strategjive manipuluese dhe mashtruese, si dhe taktikave për të shkakuar frikë te njerëzit në mënyrë që t'ia zgjasin jetën diktaturës.

Në këtë nivel, njerëzit u nënshtrohen metodave hegjemonike të dominimit, likuidimit dhe zhdukjes. Kështu, kafshët e shkretëtirës, të paafta për të duruar torturat deri në pafundësi, zhduken. Romani mund të interpretohet gjithashtu në kontekstin e teorive arketipore të Northrop Fry, arketipet individuale, kolektive dhe veçanërisht ato familjare të Jungut, dëshira për pushtet, revolta e masave, çështja e identitetit, besimit, idealizmit, materializmit. Të gjitha këto aspekte janë pjesë e gjithë romanit. Në 1984, hapësira dhe koha janë të ndërlidhura me elemente futuriste që nënkuptojnë përmbajtjen distopike të së tashmes. Dehumanizimi është një element i përbashkët si në 1984 ashtu edhe në Ditët Burmeze të George Orwell. Në veprën e tij 1984, Euroazia, Oqeania, anglo-saksonët përmenden si shkurtesa për vendet që kanë kuptim alegorik.

Ky implikim është politik, mbi të gjitha ideologjik dhe teknokratik. Personazhi kryesor Winston Smith nuk e përfundon procesin e individualizimit të tij. Si shumë personazhe të tjerë në roman, Smith është viktimë e mbikëqyrjes së vazhdueshme të teknokracisë së Big Brother (Vëllait të Madh). Edhe pse romani, i cili i përket zhanrit të fiksionit distopik, është shkruar për kohën e ardhshme, Orwell përdor metoda ose teknika tradicionale. Autori përfshin sekuencat e fëmijërisë së Winston Smith dhe disa personazheve të tjerë, të tilla si motra dhe nëna e tij e varfër dhe e pafuqishme. Këto sekuenca shpesh herë të shkëputura nga kujtesa e Winston, na tregojnë për përvojën e tij të fëmijërisë me varfërinë. Ai është vazhdimisht i uritur dhe shpesh përpiqet të marrë një copë ushqim më shumë, duke e rrëmbyer hisen e motrës së tij:

Në fund, nëna e tij theu tre të katërtat e çokollatës dhe ia dha Winston-i, ndërsa pjesën tjetër motrës së tij. Vajza mori çokollatën dhe e shikoi, duke e tundur atë. Ndoshta ajo nuk e dinte se çfarë ishte. Winston-i ndaloi dhe e shikoi për një moment. Pastaj, me një shpejtësi të papritur, ai e kapi atë copë çokollate nga dora e motrës së tij dhe vrapoi te dera. "Winston, Winston!" thirri nëna e tij. "Kthehu! Jepja motrës çokollatën e saj!" Ai ndaloi, por nuk u kthye.

(Orwell: 2009, 95)

Kështu, Orwell-i ndërthur me mjeshtëri të tashmen dhe të kaluarën, duke krijuar vizionin për të ardhmen në romanin e tij 1984, duke minuar rendin kronologjik të ngjarjeve në rrëfim. Ndërsa Orwell-i shkruan për dashurinë e ndaluar të anëtarëve të partisë, jeta private e të cilëve është plotësisht e uzurpuar, Huxley në romanin e tij *Më e mira e botëve*, shkon shumë larg në kohë, duke hamendësuar tema të tilla si vetë-fekondimi, zhvillimi i embrioneve në kushte artificiale, të kontrolluara nga persona të specializuar posaçërisht.

Huxley krijon një sistem të çuditshëm distopik në romanin e tij, duke na treguar vizionin e tij për të ardhmen, i cili në fakt nënkupton parashikime të tanishme për prodhimin e qenieve njerëzore në laborator. Kështu, të dy autorët na tregojnë vizionin e tyre specifik për të ardhmen në romanet përkatëse. Në 1984, frika është instrument me të cilin manipulojnë anëtarët e brendshëm të partisë. O'Brien kontrollon anëtarët e jashtëm të partisë, duke shkaktuar frikë mes tyre. Frika është një mjet i dobishëm që zgjat jetën e qeveritarëve shtetërorë.

Një tjetër mjet i përdorur nga anëtarët e brendshëm të partisë është dhuna. Mund të jetë dhunë fizike, siç është tortura dhe të shkaktuarit dhimbje ndaj "shkelësit". Një lloj tjetër dhune është falsifikimi i fakteve dhe historisë, zhdukja e së kaluarës, zvogëlimi i fjalëve në fjalor, veçanërisht ato që lidhen me lirinë, prosperitetin, drejtësinë, barazinë, identitetin, krenarinë, etj. Kjo është bërë nga miku i Winston Smith, i cili është një filolog specialist për gjuhën e re:

Shkatërrimi i fjalëve është një gjë e bukur. Sigurisht, shumë folje dhe mbiemra eliminohen, por ka edhe qindra emra, që mund t'i heqim qafe. Unë nuk flas vetëm për sinonimet; kjo vlen edhe për antonimet. Në fund të fundit, cili është arsyetimi për të pasur një fjalë që është plotësisht e kundërt me një fjalë tjetër? Një fjalë përmban të kundërtën e saj në vetvete. Merrni fjalën "mirë", për shembull. Nëse ekziston një fjalë "e mirë", nuk do të kishte nevojë që fjala "e keqe" të tingëllojë "e keqe", sepse ajo ka kuptimin e kundërt të saktë dhe fjala "e keqe" nuk e ka.

(Orwell: 2009, 28)

Ajo që përmend narratori në këtë episod, i referohet përpjekjeve të anëtarëve të brendshëm të partisë, për të krijuar një gjuhë të re për njerëzit e Oqeanisë, që do ta zëvendësojë anglishten. Një argument tjetër, për dehumanizimin njerëzor dhe shndërrimin e intelektualëve në qenie më të

ulta, diçka që ekziston edhe në Fermën e Kafshëve, është dialogu midis Winston Smith dhe Sam-it. Biseda manifeston hendekun shpirtëror dhe ideologjik midis përfaqësuesve të inteligjencës dhe anëtarëve të punëve të brendshme të partisë:

Ose, çfarë kuptimi ka ekzistenca e një versioni më të fortë, e fjalës "mirë", si një seri fjalësh të paqarta, të padobishme si "të shkëlqyera", "të mrekullueshme" dhe gjithë pjesa tjetër? Sigurisht, ne tashmë i përdorim ato forma, por në versionin përfundimtar të gjuhës së re nuk do të ketë asgjë tjetër. Në fund ideja e së mirës dhe së keqes, do të mbulohet me vetëm gjashtë fjalë, ose vetëm një fjalë. A nuk e shihni bukurinë e kësaj, Winston?

(Orwell: 2009, 980-981)

Kjo formë e re e gjuhës do të quhet "gagaritje". Në këtë roman gjejmë emërtime origjinale që Orwell i përdor i pari, neologjizma specifike anglo-saksonë. Orwell prezanton emërtime të tilla si "Big Brother", (Vëllai i madh), "New Speech", (Gjuha e re), "Proletarian", (proletarët), Notgood ("Jomirë"), "Double Plus", (Plus dyfish), Ministry of Love ("Ministria e Dashurisë"), Ministry of Welfare ("Ministria e Bollëkut"), etj. Veprimi tinëzar i të brendshmëve të partisë është subjekt i satirës në roman. O'Brien i tregon Winston Smith-it shembuj të shkatërrimit të kriminelëve që vepruan kundër partisë. Kjo është një lloj propagande qëllimi i së cilës, nga njëra anë është të tregojë se sa të këqij janë aziatikët, dhe nga ana tjetër, sa anëtarë brenda partisë janë "të mëshirshëm"..

Burrat vdesin sepse nuk duan të braktisin besimet e tyre të vërteta. Sigurisht, e gjithë lavdia i përkiste viktimës dhe turpit të inkuizitorit që i vuri flakën. Më vonë në shekullin e njëzetë, siç u quajtën ata, ishin totalitarë. Kishte nazistë gjermanë dhe komunistë rusë. Rusët persekutuan heretikët më mizorisht sesa Inkuizicioni. Ata mendojnë se kanë mësuar nga gabimet e së kaluarës; ata e dinë, në çdo rast, se njeriu nuk duhet të krijojë martirë. Para se t'i ekspozonin viktimat e tyre para gjyqimit publik, ata i detyruan ata qëllimisht të shkatërronin dinjitetin e tyre. I torturuan në burg derisa u neveritën, duke bërë titur se ishin të mjeruar dhe duke rrëfyer atë që u vunë në gojë, duke mbuluar gjithçka me abuzim, duke u mbrojtur me akuza të ndërsjella, të indinjuar në mëshirë. Sidoqoftë, pas vetëm disa vitesh, e njëjta gjë ndodh përsëri. Të vdekurit bëhen dëshmorë dhe poshtërimi i tyre harrohet. Edhe një herë, pse? Në radhë të parë, sepse rrëfimet që ata dhanë janë padyshim të dhunshme dhe të pavërteta. Ne nuk bëjmë gabime të këtij lloji. Të gjitha rrëfimet e bëra këtu janë të vërteta. Ne i bëjmë ato të vërteta. Dhe mbi të gjitha, ne nuk lejojmë që të vdekurit të ngrihen kundër nesh. Ju nuk duhet të imagjinoni se pasardhësit tuaj do t'ju justifikojnë, Winston. Ata kurrë nuk do të dëgjojnë për ju. Ju do të fshihen nga historia. Ne do t'ju kthejmë në gaz dhe do t'ju derdhim në stratosferë. Asgjë nuk do të mbetet nga ju, do të jeni pa emër në regjistrë dhe nuk do të mbaheni mend në kujtesën kolektive. Ju do të shkatërroheni si në të kaluarën ashtu edhe në të ardhmen. Ju kurrë nuk keni ekzistuar.

(Orwell, 2009:1139-1140)

Përfundimi

Në romanin e vitit 1984, Orwell portretizon rolin e shkencës dhe teknologjisë që mund të ndryshojë gjithçka, duke krijuar, për shembull, njerëz që kurrë nuk kanë ekzistuar ose duke bërë që njerëzit që ekzistojnë të zhduken pa lënë gjurmë në histori. E gjithë kjo ndodh nga frika e rebelimit, ose nga frika e humbjes së fuqisë së *Big Brother*. Megjithatë ekzistojnë një larmi metodash, teknologjia dhe shkenca luajnë një rol të rëndësishëm në ruajtjen e pushtetit, ashtu si burokracia e pamëshirshme që kontrollon shoqërinë, duke krijuar rrëmujë burokratike, rregulla të pamëshirshme dhe zyrtarë jo kompetentë të qeverisë: "Times 3.12.83; njofton për dyfishimin e

dyfishtë të së përditshmes, e ridërgon dështimin që të gjurmohet plotësisht.”(Orwell: 2009, 21) Ky është një shembull i një gjuhe të re që mund të përkthehet në anglishten e vjetër, domethënë anglishten standarde:

Njoftimi për urdhërin e *Big Brother* për datën 3 dhjetor 1983, është jashtëzakonisht i pakënaqshëm dhe u referohet personave inekzistentë... Dorëzoni draftin tek strukturat e autoriteteve më të larta, përpara se ta vendosni në dosje.

(Orwell 2009:26)

Njerëzit e vërtetë zhduken me të gjithë informacionet rreth tyre dhe shkojnë në mbretërinë e hiçit, e cila i pret në mënyrë të pashmangshme. Nga ana tjetër, njerëzit jorealë, të cilët kurrë nuk kanë ekzistuar, bëhen aq realë sa duket sikur ata vërtet kanë jetuar sepse ka gjurmë të tyre kudo:

Ai e shikoi edhe një herë rivalin e tij në kabinën e kundërt. Ishte sikur ajo t’i kishte thënë me siguri se ... ai ishte i zënë me të njëjtën gjë si ai vetë. Nuk kishte asnjë mënyrë për të ditur se puna e kujt do të miratohej më në fund, por ai ndjehej thellësisht i bindur se do të ishte i tij. Ekzistenca e shokut Ogilvy ishte e paimagjinueshme një orë më parë, por tani ishte një fakt. Kurioziteti i tij u zgjua nga dija se burra të vdekur mund të krijoheshin, por jo të gjallë. Shoku Ogilvy, i cili kurrë nuk ka ekzistuar në të tashmen, tani ekziston në të kaluarën, dhe pasi të harrohet akti i krimit, ai do të ekzistojë po aq autentikisht, dhe me të njëjtën provë, si Charlemagne ose Julius Caesar.

(Orwell 2009:26)

Emrat simbolik të personazheve në romanet e Orwell përcjellin karakterin e tyre filozofik, satirik dhe psikologjik. Subjekti i satirës në roman është falsifikimi i të dhënave, i cili manifeston frikën e klasës sunduese, të mishëruar në karakterin e *Big Brother*. Nga frika, ata që janë në pushtet gjithashtu përdorin dhunën e praktikuar nga Ministria e së Vërtetës, ku e gjithë historia e së kaluarës është falsifikuar. Njerëzit inekzistentë vijnë në jetë. Një shembull tipik i këtij lloji të falsifikimit është shoku Ogilvy. Mënyra e paraqitjes së "fakteve" është qesharake. Faktet e trilluara, të integruara në biografitë e njerëzve të falsifikuar, lidhen me gënjeshttrat e mëdha të Baron Minhausen. Kjo është bërë për të ngritur moralin e njerëzve të gjallë që jetojnë çdo ditë me frikën e avullimit.

Referencat

- [1]. Orwell, G. (1996), *Animal Farm*, Orlando, Signet.
- [2]. Orwell, G. (1961), *1984*. New York, Signet Classic.
- [3]. Žižek, S. (2011), *Did Somebody Say Totalitarianism?* New York, Verso.
- [4]. Боров, Ј. (2008), *Естетика*, Македонска реч, Скопје.
- [5]. Константинович, З. (1984), *Увод у упоредно проучавање књижевности*, Нолит, Београд.
- [6]. Лотман, Ј. (2005), *Структурата на уметничкиот текст*, Детска радост, Скопје.
- [7]. Jung, C. (2006), *Psikologjia analitike*, Fan Noli, Tiranë.
- [8]. Kant Immanuel, (1978), *Um i sloboda*, Nolit, Beograd.
- [9]. Makiaveli, N. (2000) *Princi*, Fan Noli, Tiranë
- [10]. Orwell, G. (2005), *1984* Zenit, Tiranë.
- [11]. Adler, A. (2010), *Të kuptosh natyrën e njeriut*, Fan Noli, Tiranë.
- [12]. Bloom, H. (1987), *George Orwell's 1984*, New York, Chelsea House Publishers.
- [13]. Dostojevski, F. (1984), *Vëllezërit Karamazov*, Rilindja, Prishtinë.
- [14]. Foucault, M. (1995), *Discipline and Punish*, New York, Vintage Books.
- [15]. Friedrich N. (2000), *Kështu foli Zarathustra*, Fan Noli, Tiranë.
- [16]. Frojd, Z. (1997), *Ese mbi luftën dhe vdekjen*, Tiranë.
- [17]. Frojd, Z. (1997), *Qëndresa dhe shtypja*, Fan Noli, Tiranë.